

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

Mënyra e faljes së namazit të Pejgamberit s.a.v.s.

Falënderimi i qoftë Allahut xh.sh., Zotit dhe Krijuesit të botëve! Përshëndetjet më të përzemërta Muhammedit a.s., familjes së tij të pastër, shokëve të tij besnikë, si dhe gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij.

Me këto pak fjalë desha që çdo muslimani dhe muslimaneje t'i ofrojë mënyrën e namazit të Pejgamberit a.s. që t'i shërbejë si shembull, ngase Pejgamberi a.s. ka thënë: "**Faluni ashtu siç më shihni mua duke u falur**"

Në vazhdim lexuesit do t'i ofrojë sqarim për këtë:

1. Të marrë abdes ashtu si e ka urdhëruar Allahu xh.sh. në kaptinën El-Maide: "**0 ju që besuat! Kur doni të ngriheni për të falur namazin, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla; fërkoni kokat tuaja e këmbët lani deri në dy zogjt...**" dhe thënien e Pejgamberit a.s. "**Nuk pranohet namazi i askujt prej jush pa abdes**".
2. Kthimi në drejtim të Kibles - Qabes me fytyrë dhe me trup gjatë namazit, duke vendosur me zemër, e jo me gjuhë, namazi që po e fal, qoftë ai farz a synet. kthimi në drejtim të Kibles është prej kushteve të namazit dhe ai nuk shfuqizohet, veçse në raste të veçanta, të cilat gjinden të sqaruara në librat të dijetarëve.
3. Tekbiri fillestar me të cilin lidhemi në namaz, e shqiptohet "**Allahu Ekber**" - "**All-llahu është më i madhi**".
4. Duke shqiptuar tekbin fillestar i ngrehim duart në lartësi të veshëve ose të supeve.

5. Dorën e djathtë e vendos mbi të majtën në gjoks, ngase kjo është transmetuar në hadithin e Vail bin Huxhrit.

6. Në fillim të rekatit të parë duhet të këndojë këtë dua, të cilën e transmeton Buhariu dhe Muslimi:

"Allahume baid bejne hataje kema baadte bejnel mashriki vel magribi. Allahume nekkini min hatajaje kema junekka eth-theabul ebjedu mine denesi. Allahume igsile hatajaje bilmai veththelxhi vel beredi."

Kuptimi në shqip:

"O Zoti im! largo midis meje dha gabimeve të mia, siç ke larguar lindjen nga perëndimi dhe, o Zoti im, m'i pastro gabimet e mia ashtu siç pstrohet rroba e bardhë nga ndotja. O Zoti im, m'i lajë gabimet e mia me ujë dhe me borë e me breshër."

Ose nëse donë në vend të kësaj duaje këndo:

"Subhaneke Allahumme ve bi hamdike ve tebareke smuke ve teala xhedduke ve la ilahe gajruke".

Kuptimi në shqip:

„I famshëm je vetëm Ti, o Allahu im! dhe lavdia të qoftë Ty! I lartë është emri Yt dhe Madhëria Joie është shumë emadhe. Nuk ka zot tjetër, përveç Teje".

Lejohet të lexohen edhe lutje tjera, që janë treguar në hadithe, bile më së miri është të lexohet njëra prej këtyre lutjeve e njëherë tjetër, tjetra e kështu me radhë. Pos lutjes thotë:

"Eudhubilahi mineshejtanirr-rraxhim, Bismil-lahirr-rrahmanirrrrahim".

Dhe pastaj lexon Fatihan, për të cilën Pejgamberi a.s. ka thënë:

"S'ka falur namaz ai që nuk e lexon suren ElFatiha".

Pastaj thotë "Amin" pa zë në namazet që imami lexon pa zë, dhe me zë në

namazet që imami lexon me zë. Në vazhdim lexon atë që e di më së miri nga Kur'ani.

7. Ngre duart në lartësi të supeve ose baraz me veshë, dhe thuaj: "**Allahu Ekber**" bjer në ruku, vendos duart mbi gjunjë dhe thuaj: "**Subhane rabijel adhim**" tri herë.

8. Duke u ngrëhur nga rukuja thotë: "**Semi Allahu limen Hamideh**" dhe përsëri ngritjen e duarve si më parë, dhe thotë: Rabena lekel hamd, prferohet t'i lidhë duart dhe t'i vendos mbi gjoks siç pat vepruar para rukusë, sepse në këtë sinjalizon hadithi i Vail bin Huxhrit.

9. Bie në sexhde duke marrë tekbir dhe duke lëshuar më parë gjunjt në tokë, mandej duart, po nëse i vie vështirë, atëherë së pari i lëshon duart pastaj gjunjt. Sexhdeja bëhet me shtatë gjymtyrë: fytyra, dy shuplakat e duarve, dy gjunjët dhe majet e gishtrinjëve të dy këmbëve. Pastaj duke qëndruar në sexhde tri herë thotë "**Subhane rabijel Ala**", duhet ditur se në sexhde është mirë që të lutemi sa më shumë Për këtë Pejgamberi a.s. ka thënë:

"**Në ruku madhëronie Krijuesin, kurse në sexhde shtojeni lutjen se shpresohet të jenë të pranuar**".

Gjithashtu Pejgamberi a.s. thotë:

" **Robi më së afërmi Zotit, është kur bie në sexhde, prandaj lutuni sa më shumë**".

. Këto hadithe i transmeton Muslimi. Pra (muslimani) është mirë që të lutet për vete dhe për muslimanët tjerë, që Allahu t'i shpërblejë me të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, pa marrë parasyshë se a është-namazi farz apo synet. Gjatë qëndrimit në sexhde ndahet barku nga kofsha, bërrylat prej anëve dhe llërët prej tokës.

10. Ngrihet nga sexhdeja me tekbir dhe mbështet mbi këmbën e majtë të shtruar, ndërsa këmba e djathtë qëndron drejt me gishtrinj paksa të lakuar. Duart i vë mbi kofsha, në atë mënyrë që gishtrinjtë të jenë të shtrirë deri te gjunjët, dhe lexon:

" 0 Zot më fal mua, më mëshiro, më udhëzo dhe më furnizo..."

11. Pastaj bie në sexhdenë e dytë dhe vepron si në të parën.

12. Pastaj duke marrë tekbir ngrihet prej sexhdesë dhe ulet duke e zgjatur më shumë se në uljen ndërmjet dy sexhdeve. Kjo ulje quhet **Ulja e pushimit**, dhe është e preferueshme sipas mendimit më të zgjedhur të dijetarëve, por edhe nëse kjo ulje lihet nuk ka ndonjë të keqe. Në këtë ulje nuk parashihet kurrfarë lutje. Pastaj ngrihet në këmbë në rekatën e dytë, duke u mbështetur me duar për gjunjësh e nëse ka nevojë, duke u ngritur mund vi mbështesim duart edhe për tokë.

Në rekatën e dytë këndon Fatihanë dhe atë që të vie më së lehti nga Kur'ani. Muketedin (xhemati) duhet të shkojë pasë imamit, e jo t'i paraprijë atij, e as ta arrij atë, sepse kjo e fundit është mekruh. Pejgamberi a.s. thotë:

" Imami është caktuar për të udhëhequr namazin (e të tjerëve). Prandaj, kur të thotë: Allahu Ekber, thoni edhe ju ashtu, por mos thoni deri sa të thotë ai. Dhe kur ai të bëjë ruku, bëni edhe ju, por mos bëni ruku, pa bërë ai. Gjithashtu kur imami thotë:

"Semiall-llahu limen hamideh" thoni: rabena lekel hamd. E kur të bëjë sexhdë, bëni sexhdë edhe ju" (transmeton Buhariu dhe Muslimi).

13. Nëse namazi përbëhet prej dy rekateve, si namazi i sabahut, i xhumasë ose i bajramit, pasi të bëjë sexhdenë e dytë, qëndron ulur, mbledh gishtrinjt e dorës së djathtë dhe gishtin tregues e lëviz. aty e lexon:

"Etehijjatu lilahi vessalavatu vet-tajibatu. Es-selamu alejke ej juhen-nebijju ve rahmetullahi ve berekatuhu, es-selamu alejna ve ala ibadillahis-salihin. Eshhedu en la ilahe ilallah ve eshhedu enne Muhammeden abduhu ve resuluhu. Allahumme sali ala Muhammed ve ala ali Muhammed, kema salejte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid. Ve barik ala Muhammed ve ala ali Muhammed, kema barekte ala Ibrahim ve ala ali Ibrahim inneke hamidun mexhid. Allahume inni eudhu bike min adhabi xhehennem ve min adhabil kabri, ve min fitneti mahjai vel menat ve fitneti mesihid dexhal".

Kuptimi:

"Nderimet tona Allahut. Atij, i takojnë të falurat tona dhe të gjitha veprat e mira. Të përshëndesim ty o Pejgamber, bekimi e mëshira e Allahut qofshin mbi ty. paçim shpëtim ne dhe të gjithë robërit e mirë të Allahut. Deklaroj që vetëm Allahu është Zot dhe deklaroj që Muhammedi është rob i Zotit dhe i dërguar i Tij.

O Zot, shfaqja mëshirën tënde Muhammedit dhe familjes së Muhammedit, sikur që i shfaqe Ibrahimit dhe familjes së Ibrahimit. Vërtetë Ti je i lavdishëm dhe i famshëm. O Zot, jepi bekimin Tënd Muhammedit dhe familjes së Muhammedit, siç ia dhe bekimin Ibrahimit dhe familjes së Ibrahimit. Vërtetë Ti je i lavdishëm dhe i famshëm.

O Zoti im, të lutem më ruaj nga dënimi i zjarrit, dhe nga dënimi i varrit dhe nga intriga (fitneja) e të gjallëve dhe të vdekurve, gjithashtu më ruaj nga intriga e Mesih Dexhallit."

Pas kësaj lut Allahun çka të dojë nga të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër, për te apo për prindërit e tij, pa marrë parasysh se a është namazi farz apo nafilë (vullnetar). Kjo mbështetet në njërin nga transmetimet e Abdullah bin Mesudit : "... **pastaj le të lutet për çka të dojë**". Pastaj kthen kokën djathtas duke thënë: "**Es-selamu alejkum ve rahmetullah.**" Pastaj në të majtën po ashtu.

14. Nëse namazi përbëhet prej tri rekateve siç fjala vjen namazi i Akshamit, ose prej katër rekateve si p.sh. farzi i drekës, i ikindisë dhe i jacisë, gjatë qëndrimit në uljen e parë në këto namaze do të këndohet teshehudin dhe salavatet. Pastaj duke thënë: **Allahu Ekber**, ngrihet në këmbë, duke i ngritur duart në lartësi të supeve, e pastaj duart i lidhë dhe i vendos mbi gjoks. Lexon kaptinën Fatiha. Mirëpo në namazin e drekës edhe nëse nga njëherë lexon diç prej Kur'anit pas fatihas nuk ka ndonjë të keqe. Këndimi i salavateve në uljen e parë është mustehab, e jo vaxhib. Prej këtui, nëse nuk i këndon fare, nuk ka asgjë të keqe. Pas rekatit të katërt të farzit të drekës, ikindisë dhe jacisë, pos këndimit të salavateve, lutet që ta ruaj Allahu, prej dënimit të ferrit, prej dënimit të varrit, nga intrigat e Mesih Dexhallit, dhe lutjes tjetër, të cilat janë të ligjshme të këndohen me këtë vend, dhe vende të tjera, prej tyre:

"Rabbena atina fit dunja heseneten ve fil ahireti haseneten ve kina adhaben nar"

,për këtë lutje Enesi r.a. thotë: "Ka qenë lutja më e shpeshtë e Pejgamberit a.s." Pas kësaj jep selam në të djathtë dhe në të majtë, duke thënë: Es selamu alejkum ve rahmetullah. Në vazhdim kërkon falje nga Zoti tri herë dhe thotë:

"Allahume entes selamu ve minkes selam tebarekte ja dhel xhelali vel ikram. la ilahe ilallahu vahdehu la sherike ieh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kuli shejin kadir. Allahume la mania lima atejte ve la mu'ti lima menate, ve la jenfes dhel xhedi minkel xhedu. la ilahe ilallah vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huve ala kuli shejin kadir. la havle ve la kuvete ila bilah, la ilahe ilallah ve la na'ubudu ila ijah lehun ni'emtu ve lehul fadlu ve lehuth-thenau hasen. la ilahe ilallah muhlisin lehud dine ve lev kerihel kafirune."

Kuptimi:

"Të kërkoj falje o Allah! (tri herë) O Allah! Ti je burimi i shpërtimit. Ty të lavdërojmë dhe të falenderojmë, lavdërimet të perkasin vetëm Ty, o Krijues i Madh e bujar". "Askush tjetër dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut, të Vetëm e të Pashoq. Ai është Zotëruesi i gjithçkaje (në qiej e në Tokë); vetëm Atij i përket falënderimi, Ai është i Plotëfuqishëm mbi gj ithçka.

O Allah! Askush nuk mund ta pengojë atë, që ti jep (për robërit e Tu): askush nuk ka mundësi që Vi japë dikujt diçka që Ti ia ke marrë. Askush sado pozitiv të lartë të ketë, nuk mund të dalë përpara Teje.

Askush tjetër dhe asgjë tjetër nuk meriton të adhurohet përveç Allahut, të Vetëm e të pashoq. Ai është Zotëruesi i gjithçkaje (në qiej e në Tokë) vetëm Atij i përket falënderimi (ynë), për gjithçka Ai është i Plotëfuqishëm.

Askush tjetër e asgjë tjetër, përveç Allahut nuk ka forcë mbi ne. vetëm Allahu meriton të adhurohet e nuk adhurojmë tjetër, përveç Tij. E Tij është mirësia që e gëzojmë. Atij i përket nderimi e lartësimi. Vetëm Allahu meriton të adhurohet. Atë e adhurojmë me çiltëri të plotë, edhe sikur (këtë çiltëri) ta urrejnë jobesimtarët."

Pastaj thotë: 33 herë "Subhanallah, 33 herë Elhamdulillah, 33 Allahuekber, dhe të njëqindtën thotë: la ilahe ilallah vahdehu la sherike leh, lehul mulku ve lehul hamdu ve huvel ala kuli shejin kadir. Pastaj e lexon ajetul kursin, kulhuvallahun, kul eudhu bi rabil felek, kul eudhu bi rabin nas pas çdo namazi, bile preferohet që këto tri kaptina të këndohen nga tri herë.

Të gjitha këto lutje pas namazit janë të miratuara me hadithe të shumta, prej tyre hadithi i Aishes r.a. në përmbledhjen e imam Muslimit. Duhet ditur se këto lutje janë synnet, e jo farz. Mustehab është që çdo musliman dhe muslimane që të falë para farzit të drekës katër rekate, e pas tij dy, gjithashtu pas farzit të akshamit dhe të jacisë nga dy rekate, dhe para farzit të sabahut dy rekate, gjithsejt 12 rekate.

Këto synete Pejgamberi a.s. i ka falë vazhdimisht, me përjashtim kur ka qenë udhëtar. Përderisa është kështu, atëherë Pejgamberin a.s. duhet ta kemi shembull në tërë këtë, sepse Allahu xh.sh. lidhur me këtë thotë: "... **ju e kishit shembull më të lartë në të dërguarin e Allahut**" (El-Ahzab: 21). Gjithashtu kemi hadithin e Pejgamberit a.s. "**Faluni ashtu siç më keni parë ju mua duke u falur**" (Buhariu)

Më mirë është që synetet dhe vitri të falen në shtëpi, por nëse falen në xhami nuk ka kurrnjë të keqe. Pejgamberi a.s. ka thënë: "**Më i miri namaz, është ai që njërin e fal në shtëpi, përveç farzeve.**" Moslënia e syneteve konsiderohet njëri prej kushteve të hyrjes në Xhenet. Transmeton Muslimi nga Umu Hubibja r.a., e cila ka treguar se e ka dëgjuar Pejgamberin a.s. duke thënë:

" **Çdo musliman, i cili vullnetarisht falë 12 rekate namaz, përveç farzeve, Allahu xh.sh. ka për t'ia ndërtuar një shtëpi në xhenet.**"

Mirë është që të falë 4 rekate para farzit të ikindisë dhe nga dy rekate para farzit të akshamit dhe të jacisë. Mbështetje për këtë kemi hadithin:

"**Zoti e mëshiroftë personin, i cili fal katër rekate para farzit të ikindisë**" dhe hadithin "**ndërmjet çdo ezani dhe ikameti ka namaz (nafi)**"

Pas 4 rekateve synet, që falen para farzit të drekës është mirë t'i falim edhe 4 rekate pas farzit për këtë Pejgamberi a.s. thotë: "**Kush i kushton kujdes katër**

rekateve para drekës dhe katër pas saj, Allahu xh.sh. do t'ia ndalojë (bën haram) zjarrin e xhehenemit" (trnasmeton Ahmedi dhe katër autorët e syneneve me sened të shëndoshë). Nga ky hadith kuptohet se kush i shton dy rekate pas farzit të drekës dhe i bën katër rekate, e arrin atë që u përmend në këtë hadith. E lusim Allahun e Lartmadhërishëm që të na mundësojë që të shohim të vërtetën e vërtetë dhe të na ndihmojë që ta pasojmë atë, dhe të na bëjë të mundshme që ta shohim të pavërtetën e pavërtetë dhe të na ndohmojë që të largohemi prej saj, të na udhëzojë në rrugën e drejtë, dhe salavatet dhe selamet e All-llahut qofshin mbi të dërguarin e Tij, familjen, shokët dhe të gjithë pasuesit e tij!

Detyrëshmëria e namazit të të sëmurit

Falënderimi i qoftë Allahut xh.sh., Zotit dhe Krijuesit të botëve! Përshëndetjet më të përzemërta Muhammedit a.s., familjes së tij të pastër, shokëve të tij besnikë, si dhe gjithë atyre që e ndjekin rrugën e tij.

O vëlla musliman! Ki kujdes lënien e namazit, madje edhe në rast sëmundjeje. Sepse ai (namazi) është obligim për ty. Bile Allahu namazin e ka bërë obligim edhe për luftëtarët në luftë. Le ta dijë çdokush, se namazi jep qetësi shpirtërore për të sëmurin dhe e ndihmon atë që të shërohet. Allahu i madhëruar ka thënë:

" *Kërkoni ndihmë*

(në të gjitha çështiet) me durim dhe në namaz ..." (Sure

El-Bekare, ajeti 45)

Profeti s.a.v.s. i thoshte Bilalit: "**0 Bilal! Bën thirrjen për namaz, e na qetëso neve me të.**" Këtë hadith e transmeton Ebu Daudi.

Është shumë e dobishme për të sëmurin, që t'i vijë exheli (fundi i jetës) e të vdesë duke falur namazin dhe të mos vdes duke qenë kundërshtar me

braktisjen e namazit. Allahu i madhëruar i ka lehtësuar të sëmurit dhe i ka lejuar që ta falë me tejemum kur nuk ka mundësi të përdor ujin për abdest e për Vu larë nga xhunubllëku. E këtë lehtësim e ka bërë me qëllim që të mos e lë namazin (pa e falur).

Allahu i madhëruar ka thënë:

"O ju që besuat! Kur doni të ngriheni për ta falur namazin, lani lytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në brryla; fërkoni kokat tuaja, e këmbët lani deri në dy zogjt. Nëse jeni xhunubë, atëherë pastrohuni (lahuni)! Në qoftë sejeni sëmure ose në ndonjë udhëtim, ose ndonjëri prej jush vien prej vendit të nevojës, ose keni kontaktuar me gratë dhe nuk gieni ujë, atëherë mësynie (merrni tejemum) dheun e pastër dhe me të fërkoni fytyrat dhe duart tuaja. Allahu nuk dëshiron (me obligim për abdest dhe larje) t'iu sjell ndonjë vështirësi, por dëshiron të ju pastrojë (prej mëkateve), e të ju plotësoi të mirën e Tij ndaj jush e që ti falënderoheni." (Sure El Maide)

SI PASTROHET I SËMURI ?

1. 1 sëmuri duhet të pastrohet me ujë dhe duhet të marrë abdes, (pastrohet nga papastërtia e vogël) dhe të lahet (nga papastërtia e madhe-xhunubllëku).
2. Në qoftë se nuk ka mundësi të pastrohet me ujë ngase nuk është i paaftë ose ka frikë se i shtohet sëmundja, ose i vonohet shërimi, atëherë bën tejemum (me dhe).
3. Mënyra e bërjes tejemum: i vendos duart në një tokë të pastër një herë dhe me ato fërkon fytyrën komplet, pastaj fërkon shuplakat (duart) me njëra tjetrën.
4. Në qoftë se s'mund të pastrohet vetë, duhet t'i japë abdest ose tejemum një njeri tjetër.
5. Në qoftë se në disa gjymtyra të abdestit ka plagë, duliet ta lajë me ujë. Por po qe se larja me ujë e dëmton, atëherë duhet ta fërkojë lehtë me dorë të

lagur. E në qoftë se edhe mes-hi (fshirja ashtu) e dëmton, atëherë bën tejemum.

6. Në qoftë se në njërin nga gjymtyrët ka thyerje, që e ka lidhur me fashë, ose allçi, atëherë , bën mes-h sipër me dorë të lagur, në vend të larjes, dhe s'ka nevojë të bëjë tejemum, sepse mes-hi zëvendëson larjen (me ujë).

7. Lejohet të bësh tejeëmum në mur ose mbi një gjë tjetër të pastër, që ka pluhur (dheu). Ndërsa po të jetë muri i fshirë më diçka, që nuk është nga lloji i tokës, si bojë, nëse nuk ka pluhur dheu mbi të, nuk lejohet tejemumi mbi të.

8. Në qoftë se tejemumi nuk është në tokë ose në mur, ose mbi një gjë tjetër që ka pluhur, atëherë lejohet të vendoset pak dhe në një enë, ose në një shami dhe me atë të bëjë tejemum.

9. Në qoftë se ka bërë tejemum për një namaz dhe ka vazhduar të jetë i pastër (pa e prishur) derisa vjen koha e namazit tjetër, ai falet përsëri me atë tejemumin e parë dhe nuk e ripërsërit tejemumin për namazin e dytë, sepse akoma vazhdon të jetë i pastër dhe nuk ekziston ndonjë gjë që ta prishë atë.

10. I sëmuri duhet ta pastrojë trupin e vet nga ndytësi, por në qoftë se nuk ka mundësi të pastrohet, le të falet ashtu si të ketë mundësi, dhe namazi i tij është i vlefshëm, e s'ka arsye që ta ripërsëris atë.

11. Gjithashtu, i sëmuri duhet të falet me një rrobe të pastër, por po t'i ndyhen rrobat, i duhet t'i lajë ose t'i ndërrojë ato me një rrobe të pastër. Por, po qe se nuk ka mundësi, le të falet ashtu si të mundet dha namazi i tij është i vlefshëm dhe nuk i duhet ta ripërsëris atë (namazin).

12. I sëmuri duhet të falet mbi një gjë të pastër, e në qoftë se i ndyhet vendi ku fal namaz, atëherë duhet ta lajë, ose ta ndërrojë me një gjë të pastër, ose t'i shtrojë sipër një gjë të pastër. Por, po qe se nuk ka mundësi, le të falet ashtu si të mundet e namazi i tij është i vlefshëm, e s'duhet ta ripërsëris.

13. Nuk i lejohet të sëmurit që ta vonojë namazin nga koha, për arsye të pamundësisë që të pastrohet. Por, duhet të pastrohet ashtu si të ketë mundësi dhe le ta falë namazin në kohën e vet, sikur edhe të ketë mbi trupin ose në

rroben e vendin e tij ndytësirë, që s'ka mundësi ta pastrojë atë.

SI FALET I SËMURI

1. I sëmuri është i obliguar që t'i falë farzet në këmbë ose i përkulur, ose i mbështetur rmbi mure, ose i mbështetur në shkop, kur ka nevojë të mbështetet mbi të.

2. Në qoftë se nuk ka mundësi të qëndrojë në këmbë, le të falet ulur. Por më mirë është të qëndrojë ashtu mbi këmbën e majtë ulur, në vend të qëndrimit në këmbë ose ruku (kur s'ka mundësi t'i kryejë ato).

3. Në qoftë se s'ka mundësi të falet ulur, le të falet në njërën ijë (shtrirë) i kthyer nga kibleja, por është më mirë të jetë në anën e djathtë. Ndërsa nëse nuk ka mundësi të kthehet nga Kibleja, le të falet nga mund të kthehet dhe namazi i tij është i vlefshëm, ndaj s'ka nevojë ta ripërsërisë atë.

4. Në qoftë se s'ka mundësi të falet në ijë, le të falet prapë (në kurriz) duke 1 drejtuar këmbët kah kibleja. Por më mirë është ta ngrejë kokën pak, me qëllim që të kthehet ka kibleja. E në qoftë se nuk mund ti shtrijë këmbët kah kibleja, le të falet kah të mundet dhe s'ka nevojë ta

ripërsërisë namazin.

5. I sëmuri duhet të bëjë ruku e sexhde në namazin e vet, por në qoftë se nuk mund, le të bëjë shenjë me kokë për ruku dhe në sexhdenë, por shenja për sexhdenë duhet të jetë më e ulët sesa për rukunë. E në qoftë se ka mundësi të bëjë rukunë, e jo sexhdenë, atëherë le ta bëjë rukunë e plotë dhe për sexhdenë le të bëjë shenjë. Kurse po qe se për sexhdenë ka mundësi ta bëjë dhe për rukunë jo, le ta bëjë sexhdenë e plotë, e për rukunë le të bëjë shenjë me kokë dhe s'ka nevojë për jastik që të bëjë sexhde mbi të.

6. Po në qoftë se nuk ka mundësi të bëjë shenjë për ruku e sexhdenë me kokë, le të bëjë shenjë me sy, duke i mbyllur pak për rukunë, dhe më shumë për sexhdenë. Ndërsa të bërit shenjë me gisht, ashtu siç bëjnë disa të sëmure, nuk ka vlerë dhe nuk ka kurrnjë vlerë nga Kur'ani ose suneti, e as nga fjalët e dijetarëve islamë.

7. Në qoftë se nuk ka mundësi të bëjë shenjë me kokë e as me sy, le të falet me zemër. Pra le të thotë Allahu Ekber dhe le të lexojë Kur'an atë pjesë, të cilën e di më mirë, pastaj ta bëjë nijet me zemër, sikur bën ruku e sexhde, e sikur qëndron në këmbë, e sikur rri ndenjtur (ulur). Kështu e kryen namazin, sepse çdo njeri merr atë që pati nijet (synim).

8. I sëmuri duhet ta falë çdo namaz në kohën e vet dhe të veprojë sipas mundësisë që ka për çdo detyrë. E në qoftë se i vjen vështirë ta kryej çdo namaz në kohën e vet, i lejohet ta bashkojë drekën me ikindinë dhe namazin e akshamit me atë të jacistë ose duke bërë bashkim të avancuar, si duke e falur ikindinë në kohën e ylesë dhe jacinë në kohën e akshamit, ose me bashkim të vonuar, duke e vonuar ylenë për në kohën e ikindisë dhe akshamin në kohën e jacistë, ashtu si t'i vijë më lehtë të sëmurit. Ndërsa namazin e mëngjesit, s'mund ta bashkojë as me atë para, dhe as me atë prapa.

9. Kur i sërniuri është udhëtar, dhe kurohet jo në vendin e vet, atëherë namazet që janë me katër re'katë i shkurton. Pra, drekën, ikindinë dhe jacinë i falë me nga dy re'katë, derisa të kthehet në vendin e vet, qoftë ai udhëtim i gjatë a i shkurtër.